Vrasja në Ferizaj që dyshohet se e kreu një polic, gjithçka që dihet deri më tani

LAJME

17/08/2024 08:29

Një 89-vjeçar është vrarë mbrëmë në oborrin e një sallë dasmash në fshatin Bibaj të Ferizajt. I dyshuari është një zyrtar policor. Për rastin deri tash janë dy të arrestuar.

Një vrasje ka ndodhur mbrëmë në fshatin Bibaj të Ferizajt. Në oborrin e një salle dasmash është vrarë një 89-vjeçar dhe i dyshuari për vrasjen e të moshuarit është një zyrtar policor i cili dyshohet se vrasjen e ka kryer me armë zyrtare edhe pse ishte jashtë detyrës zyrtare.

I njëjti është arrestuar dhe i është caktuar masa e paraburgimit prej 48 orësh. Lidhur me rastin detaje ka dhënë Inspektorati Policor i Kosovës. Sipas IPK-së, ngjarja ka ndodhur rreth orës 19:30.

Bazuar në informacionet fillestare, IPK-ja thotë se dyshimet janë se zyrtari policor i dyshuar në këtë rast kishte shkuar në këtë lokacion dhe kishte shtënë me armë zjarri në drejtim të viktimës, i cili si pasojë e lëndimeve të pësuara ka ndërruar jetë .

I njëjti më pas ishte dorëzuar në polici.

"I dyshuari në këtë rast (zyrtari policor) pas kryerjes së veprës penale është vetdorëzuar në Stacionin Policor të Ferizajt ku edhe ka dorëzuar armën zyrtare e cila dyshohet se është përdorur në këtë rast. I dyshuari është arrestuar (dhe suspenduar) dhe me vendim të prokurorit të njëjtit i është caktuar masa e ndalimit për 48 orë për shkak të dyshimit të veprës penale "Vrasja e rëndë" sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e IPK-së.

Majori Qazim Reka në një deklaratë për media ka treguar detaje të reja lidhur me rastin, duke shtuar se polici nuk ishte në detyrë në kohën kur kreu vrasjen.

Ai para gazetarëve ka bërë me dije se polici nuk ka qenë pjesë e ahengut familjar, duke shtuar se motivet ende nuk dihen.

"Polici nuk ka qenë në detyrë zyrtarë, jashtë detyrës zyrtare, ka qenë me rroba civile dhe me veturë civile ka kryer veprën në vendin e ngjarjes këtu para këtij lokali. Vrasja është kryer me armë zyrtare. Zyrtari policor është F.R dhe viktima është S.S....Motivet nuk dihen ende. Nuk ka qenë pjesë e ahengut familjar", tha Reka.

Për rastin janë deklaruar edhe nga Prokuroria Themelore e Ferizajt.

Në njoftimin e prokurorisë thuhet se i dyshuari në këtë rast sipas informatave të para dyshohet se është zyrtar policor dhe i njëjti me vendim të Prokurorit të Shtetit, është ndaluar në kohëzgjatje prej 48-orësh për shkak të dyshimit të veprës penale "Vrasja e rëndë".

"Hetuesit Rajonal të Policisë së Kosovës në Ferizaj në koordinim me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Ferizaj z.Shukri Jashari dhe prokurorin kujdestar kanë dalë në vendin e ngjarjes si dhe nga ekipi mjekësor është konstatuar vdekja e viktimës. Për informata tjera rreth rastit, Prokuroria Themelore në Ferizaj do të iu njoftoj me kohë", thuhet në njoftim.

Lidhur me rastin, IPK ka njoftuar më vonë se është arrestuar edhe një i dyshuar.

"Lidhur me rastin e vrasjes në Ferizaj i cili është raportuar sot në orët e mbrëmjes është arrestuar edhe një i dyshuar. Të dyshuarit të arrestuar me vendim të prokurorit i është caktuar masa e ndalimit për 48 orë për shkak të dyshimit të për bashkëkryerje të veprës penale "Vrasja e rëndë" sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës", thuhet në reagim.

Më shumë nga uebi

nativegram by LuponMedia

Rrjedh uji, dëmtohen disa zyre në Kuvendin e Kosovës

Florentino Perez e ndryshon lojën, një ofertë e madhe për


Pas kufizimit të alkoolit, Gani Gërmia pin alkool

Reader Favorites: Top 25 Recipes from 2023

"O Bes Kallaku", reagimi epik i Xhensilës kur fansat i

LAJME TË FUNDIT

Policët s'kanë të drejtë të bartin armët e...

Edhe anëtarja e bordit të RTK-së, Arta Berisha...

Ka nisur sërish ndërhyrja e KFOR-it për të...

Gërvalla për rastin në Ferizaj: Presidentja po sulmohet...

Lajmi mëngjes

Artikuj të ngjashëm

August 17, 2024
Policët s'kanë të drejtë të bartin armët e gjata jashtë detyrës...

August 17, 2024
Edhe anëtarja e bordit të RTK-së, Arta Berisha dorëhiqet nga pozita,...


August 17, 2024
Ka nisur sërish ndërhyrja e KFOR-it për të shuarjen e vatrave...


August 17, 2024
Gërvalla për rastin në Ferizaj: Presidentja po sulmohet ende pa pasur...

August 17, 2024
SHBA-ja mohon se ka nxitur protestat në Serbi


August 17, 2024
Serwer: Çështja tashmë është se cila është më e rëndësishme për...

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy